

Zgjidhje përfundimtare apo Status Quo

Këshilli për Qeverisje Gjithpërfshirëse (CIG) ka mbledhur në Prishtinë, më 18 qershor 2019, disa politikanë, analistë, dhe përfaqësues të shoqërisë civile për të diskutuar dinamikat e reja të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, si dhe hapat që duhet të ndërmerren për ta rifilluar dialogun. Tryeza e diskutimit është pjesë e një iniciative të CIG mbi marrëdhëniet Kosovë-Serbi, e mbështetur nga dhe zbatuar në bashkëpunim me Departamentin Federal të Zvicrës për Punë të Jashtme.

Tryeza e rumbullakët doli me disa përfundime dhe rekomandime.

- *Konsensus transatlantik dhe udhëzues.* SHBA dhe BE duhet të bijnë dakord në disa parime dhe të gjejnë një pikë të përbashkët për një zgjidhje përfundimtare. Edhe pse rezultati përfundimtar që dëshirohet të arrihet është mëse i qartë—pra, normalizimi i marrëdhënieve mes dy shteteve të pavarura—akoma nuk është e qartë se si të arrihet deri tek ky rezultat. Prandaj disa udhëzime që sjellin deri tek një zgjidhje përfundimtare, drejtuar nga SHBA dhe BE, janë hap i nevojshëm për një rezultat të shpejtë dhe të suksesshëm. SHBA dhe BE duhet poashtu të garantojnë që në rast se arrihet një marrëveshje e tillë, ajo duhet të jetë e zbatueshme.
- *Iniciativa Gjermano-Franceze: të blihet kohë apo të ofrohen zgjidhje?* Për shkak të mungesës së përkushtimit për një iniciativë të guximshme, BE thjesht po blen kohë përmes proceseve siç është ai i dialogut të Brukselit, si dhe tani iniciativa Merkel-Makron. Një iniciativë serioze do të përfshinte a) një listë udhëzimesh dhe parimesh të qarta për pajtim për një zgjidhje përfundimtare, dhe b) një udhëzues për integrimin në BE për Serbinë dhe Kosovën me detyra të qarta shtetërore, orare, si dhe një përkushtim të BE-së që mbështetë tranzicionet në aspektet politike dhe financiare. Iniciativa Berlin-Paris nuk duket që është duke i përfshirë këto elemente. Iniciativa poashtu bart disa rreziqe: nëse Merkel dhe Makron dështojnë, askush tjetër nuk do të guxonte të marrë përsipër dialogun. Prandaj, nëse ky proces nuk rezulton të jetë i suksesshëm, dëmi që do t'i shkaktohet dialogut do të jetë afatgjatë. Disa thonë që problem nuk qëndron tek përfaqësuesit ndërkombëtarë, por tek ata nga Kosova dhe Serbia. “Është e vështirë të ketë proces më të mire se ai i Brukselit, sepse nuk është vetëm për shkak të paaftësisë së Mogherinit ta ndërmjetësojë, por çështja qëndron tek Prishtina dhe Beogradi, të cilët nuk po duan të arrijnë kompromise të guximshme.
- *Nëse nuk mund të zgjidhet konflikti, atëherë duhet të rregullohet.* Një zgjidhje ideale do të ishte normalizimi i plotë mes Kosovës dhe Serbisë. Mirëpo, akterët ndërkombëtarë dhe vendor duhet të kenë një plan B: të rregullohet konflikti përmes bashkëpunimit. Kjo do ta linte statusin anash, mirëpo do të ofronte bashkëpunim institucional, duke përfshirë atë mes policisë dhe gjykatave. Të dy palët kanë interes të përbashkët në dialog dhe të përmbushnin interesat përmes tregtisë. Dialogu i Brukselit ka operuar nën parime të ngjashme: për shembull, nuk solli deri në njohjen e dokumenteve të udhëtimit, por e ka rregulluar çështjen e

përdorimit të tyre. Prapëseprapë, ky nuk ishte opsioni ideal. Plani B duhet të përdoret vetëm si opsion i fundit.

- *Krerët e Kosovës dhe Serbisë nuk e kanë për ngut marrëveshjen.* Krerët kosovarë dhe serbë nuk duket ta kenë për ngut çështjen e situatave vendore dhe zgjidhjen e konfliktit të statuseve të tyre. Demokracitë e Kosovës dhe Serbisë nuk janë në formën më të mirë të mundshme. Krerët i frikësohen faktit që nëse bëhet forcimi i sundimit të ligjit, kjo do të ndikonte në interesat e tyre personale. “Një sundim i forte i ligjit do t’i dëmtonte së pari udhëheqësit.” Serbia ka Kapitullin 35, që nënkupton normalizim gjithëpërfshirës me Kosovën, por nuk nxiton të zbatojë këtë kapitull, përderisa ka Kapituj më të vështirë—siç janë Kapitulli 23 dhe 24—të cilët e vonojnë anëtarësimin në BE prapëseprapë. Poashtu, krerët nuk duken të jenë të interesuar të orientohen kah sundimi i ligjit aspak. “Ata më përpara preferojnë të udhëheqin në shtete të dobëta dhe të pazhvilluara sesa të burgosen në shtete ku sundon ligji.” Mosmarrëveshja për statusin është konflikt perfekt që i mban krerët e Kosovës dhe Serbisë në fuqi. Zgjidhja e konfliktit do të shkaktojë pasoja për pozitat e tyre, “prandaj ata nuk do të mundohen ta këpusin pemën prej së cilës ushqehen.”
- *Sa e rëndësishme është për Kosovën njohja nga Serbia?* Jo edhe aq. Prapëseprapë, e gjithë politika e jashtme e Kosovës është e fokusuar në njohjen nga Serbia, gjë që e bën të tingëllojë thua se Kosova nuk mund të përparojë as edhe një centimeter pa njohjen nga Serbia. Kjo gjë i ka dhënë Beogradit shumë përparësi për negociata dhe fuqi. Sikur të mos mjaftonte fokusi i gjithë qeverisë, presidentit, dhe parlamentit në dialog nuk po i mjaftonte, Kosova poashtu përpiloi një draft-ligj për dialogun dhe themeloi një ekip të madh, gjë që së fundi u pa si e jashtëligjshme nga Gjykata Kushtetuese. Fokusi i institucioneve të Kosovës për të marrë njohjen nga Serbia e ka bërë Beogradin të besojë se mund të marrë diçka të madhe si shkëmbim, në rast se e njeh Kosovën. Deklaratat e Presidentit Thaçi që “Kosova do të bëhet sikur Palestina pa njohjen nga Serbia” nuk kanë çuar peshë. Është ide e gabuar se nëse Serbia e njeh Kosovën, Rusia do të mbështesë anëtarësimin e Kosovës në OKB, dhe se dhe pesë shtetet e BE-së që deri tani nuk e kanë njohur Kosovën, do ta njohin menjëherë. Krerët e Kosovës e kanë instrumentalizuar konfliktin me Serbinë për të mbuluar keq-menaxhimin e shtetit. “Të gjithë flasin për Serbinë, por askush nuk merret me sundimin e ligjit, arsimin dhe shëndetësinë.” Mirëpo, disa folës, u shprehën se njohja e Kosovës nga Serbia është çështje kyqe për Kosovën, por nuk ka shumë mundësi të ndodhë në “kufijtë ekzistues të Kosovës.”
- *Retorika e krerëve është jashtë kontrollit.* Zyrtarët kosovarë dhe serbë nuk po përmbahen më kur bie fjala për deklarata raciste, gjuhë urrejtjeje, apo pretendime të hapura territoriale. Kjo retorikë i zvogëlon gjasat për vazhdimin e dialogut dhe ndikon në marrëdhënjet mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Përkundër kësaj retorike, çështja e status quo qëndron. Disa kanë deklaruar se synimi i iniciativës Merkel- Makron është që në fakt ta menaxhojë, më përpara se ta zgjidhë konfliktin. “Iniciativa synon të menaxhojë status quo-në.”
- *Të bëhet thirrje më e madhe për identitetin e Kosovës.* Presidenti Trump nuk është i vetmi që e sheh identitetin më shumë në baza etnike, sesa në ato qytetare. Kosovarët e kanë të njëjtin problem. Duke qenë se identitetet kombëtare janë “të imagjinuara”, identiteti etnik Serbë-Kosovarë, Shqiptarë—do të mposhtë identitetin kombëtar—Kosovarë—për vitet që pasojnë. Shqiptarët dhe serbët duhet të gjejnë një të përbashkët të mirë, diçka që ndajnë së bashku. Ata mund të jenë më përpara “qytetarë” sesa “etnitet”, por kategoria “qytetarë” duhet të bëhet më domethënëse dhe më e dukshme. Komunitetet etnike dueht të ndajnë në mënyrë të barabartë përfitimet kolektive- sigurinë, stabilitetin, dhe prosperitetin ekonomik—të cilat

janë vlerat kryesore të shtetësisë. Shumë serbë nuk ndihen sikur kanë qasje të barabartë në përfitimet kolektive. “Kur i dëgjon politikanët kosovarë, dhe duke i analizuar veprat e tyre, është e qartë se ata e shohin Kosovën më shumë si shtet të shqiptarëve, sesa si shtet të kosovarëve.” Politikanët vazhdojnë të definojnë shtetin e Kosovës në terma historikë, si rezultat i vështirësive kundër Serbisë. Kjo është një qasje përjashtuese ndaj komuniteteve etnike. Në këtë kontekst, është e vështirë për serbët të shpiejnë identifikimin e tyre nga “etnik” në “kombëtar.” “Ne s’mund të presim që komunitetet e vogla të bëhen “qytetare” përderisa komuniteti shumicë mbetet shumë “etnik”. Për shqipëtarët është më e lehtë të identifikohen me Kosovën, pasi ata tashmë e definojnë Kosovën si shtet të shqiptarëve. Një numër i pjesëmarrësve thane që ka nevojë të bëhet thirrje më e madhe për identitetin e Kosovës.

Pjesëmarrësit

Ardian Arifaj, Këshilltar i Presidentit të Kosovës

Belul Beqaj, Analist

Ilir Deda, Deputet i Parlamentit të Kosovës, Alternativa

Aida Derguti, Deputet i Parlamentit të Kosovës, Partia Social-Demokrate

Shpetim Gashi, Zëvendës President, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Bajram Gecaj, Këshilltar i Kryetarit të Partisë, Lidhja Demokratike e Kosovës

Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës; Zëvendës Kryetar, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

Una Hajdari, Gazetare

Vincent Hug, Sekretar i parë, Ambasada e Zvicrës në Kosovë

Dalibor Jevtic, Zëvendës Kryeministër i Kosovës

Jeta Krasniqi, Menaxhere Projekti, Instituti Demokratik i Kosovës

Jean-Hubert Lebet, Ambasador i Zvicrës në Kosovë

Ljubisa Mijacic, Analist

Branislav Nesovic, Analist

Nenad Radosavljevic, Kryetar i bordit, Rrjeti i kanaleve televizive serbe në Kosovë

Lazar Rakic, Menaxher Programi, Qendra e Ndërmjetësimit në Mitrovicë

Naim Rashiti, Drejtor Ekzekutiv, Grupi Huluntues për Politikën e Ballkanit

Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Korab Sejdiu, Deputet i Parlamentit të Kosovës, i pavarur

Boban Simic, Menaxher Programi, Aktiv

Sanja Sovrljic, Kryeredaktore, Crno Beli Svet

Xhelal Svecla, Deputet i Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje